



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5707 Prot.

Roskovec, më 27.10 2020

VENDIM

NR 79 .DATË 26.10 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN SHTATOR 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.09.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 4981/1 Prot.

Roskovec, më 29.09.2020

Procesverbal Nr.9

-I mbajtur sot, date 28.09.2020, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite si me poshte :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2020.
5. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me këste.
6. Për ndryshim dhe disa shtesa në Vendimin Nr.105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”
7. Për anulim të pjesshëm të VKB Nr.52 datë 29.06.2020 dhe VKB Nr.27 datë 27.04.2020.
8. Për një ndryshim në vendimin Nr.61 datë 28.07.2020 “Për dhënien me qira të truallit për tu përdorur për qëllime kulturore, arsimore dhe sportive”.
9. Për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe studimit të fizibilitetit për “Stacion transferimi të mbetjeve në Bashkinë Roskovec”.
10. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
11. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave nga shoqëria aksionere “Alpetrol” në pronësi të Bashkisë Roskovec.
12. Për miratimin e Formularit Tip për paraqitjen e kërkesave, për cdo program social strehimi.
13. Informacion mbi ndërtimin e Memorialit, Roskovec.
14. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁵

Keshilltaret prezent: A.Kola, K.Kuka, V.Mata, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, V.Stani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : Rrapi Hazizi, Borana Kuka, Tajane Kuka, Anxhela Hazizi.

Prezent nga administrata e bashkise: Kryetarja e bashkise, Dr. Finances, Dr. Juridike, Dr. Urbanistikes, P/Z/tatim-taksave, P/Z/ndihmes ekonomike, inxhinieri dhe eksperti per mbetjet urbane, P/Z/MZSH, P/Sherbimeve.

Me plotesimin e kuoromit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes 17 keshilltare. Kryetarja e bashkise i uron mirseardhjen ne sallen e re te keshillit ne godinen e re te bashkise. Kjo salle do i sherbeje me mire kryerjes se detyrave ndaj komunitetit. Kryetari fillon mbledhjen.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites se sotme dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Gusht 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet qe u moren ne muajin Gusht, zbardhjen e tyre dhe ndarjen e vendimeve sipas karakterit te tyre. Vendimi normativ eshte miratuar nga Prefektura.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

4. Per dhenien e Ndiemes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Gusht 2020.

Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

5. Per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura me keste.

P/Z/tatim-taksa D. Dhima sqaron projektvendimin per shlyerjen e detyrimeve me keste per familjet dhe bizneset, e kemi bere per tu ardhur ne ndihme taksapaguesve. Do te lidhet marrveshje me taksapaguesit. Leksi-formularin e kemi pare, kur lidhet marrveshja ka nje tavan te pageses dhe afat kohor? Elmazi-u vjen ne ndihme qytetareve dhe bizneseve, ta kalojme ne votim. Aleksander-eshte per tu falenderuar bashkia per kete nisme. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

6. Per ndryshim dhe disa shtesa ne Vendimin Nr.105 date 22.11.2019 "Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2020"

Aleksander-ishte me VKM ska diskutime per kete pike. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

7. Per anulim te pjesshem te VKB Nr.52 date 29.06.2020 dhe VKB Nr.27 date 27.04.2020.

Dr. Juridike D. Hoxha sqaron projektvendimin e anulimit. Sqaron gjithe praktiken dhe vendimet e keshillit te cilet do te anulohen pjeserisht. Familja Driza nuk ka pranuar te negocioje si per blerjen e apartamenteve ashtu edhe per marrjen ne huaperdorje. Kryetarja-bashkia e beri gjithe proceduren per te strehuar kete familje. Familja Driza nuk pranon ne menyre kategorike te strehoet ne apartamentin qe ne ua kemi dhene me VKB. Jane bere verifikimet nga grupet e punes dhe rezulton se ata jetojne ne apartamentin e tyre qe e kane ne pallat. Ne kemi kerkesa nga te tjera familje per strehim. Mbledhjen tjeter do keni projekt nga familje tjeter te cilet kane bere kerkese per strehim. Ju i kemi dhene vitin e kaluar edhe pagesen e qerases kesaj familje. Kemi edhe konfirmimin e ASHK qe ata kane apartament ne emrin e babait te tyre. Nuk kemi me detyrim ligjor dhe moral per kete familje, pasi ajo nuk pranoi asnje lloj strehimi alternativ qe ne i ofruam. Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

8. Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.61 date 28.07.2020 "Per dhenien me qira te truallit per tu perdorur per qellime kulturore, arsimore dhe sportive".

Dr. Juridike sqaron se kemi vetem ndryshim te siperfaqes, keto jane prona te bashkise dhe jane me vertetim hipotekor. Kryetarja sqaron se mbledhjen e kaluar kishte nje pasaktesi ne siperfaqe, prandaj e kemi sjelle perseri per te saktuar siperfaqen per ti hapur rruge procedures ligjore te dhenies me qira. Genci-ku ndodhet kjo prone aktualisht? Kryetarja sqaron se nje pjese para shkolles dhe pjesa tjeter pas shkolles. Sqaron se ka kaluar shpronasim dhe pronar eshte bashkia, eshte me dokumenta. Asnje nga qytetaret nuk ka te drejte pronesie ne kete prone. Ka procese gjyqesore por vetem per vleren e prones, jo te shpronasimit. Hidhet ne votim projekti sipas ndryshimit te paraqitur nga zyra dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro (3/5+4) vota pro.

9. Per miratimin e planit te menaxhimit te integruar te mbetjeve te ngurta urbane dhe studimit te fizibilitetit per "Stacion transferimi te mbetjeve te Bashkise Roskovec".

Kryetarja-bashkia eshte pjese e nje projekti me GIZ ne lidhje me mbetjet e ngurta, me qeverin shqiptare. Pa keto dy dokumenta ne nuk vazhdojme dot me procedurat dhe aplikimet e tjera. Ky plan do te kete gjithë rekomandimet e duhura se cfare duhet bere per qytetin e Roskovecit. Z. Rezart inxhinieri sqaron planin e menaxhimit te mbetjeve te ngurta urbane me video-projektor. Sqaron se mund te kete disa permiresime gjate rruges. Qellimet e planit reduktimi i ndotjes se mjedisit ne Bashkine Roskovec. Ne baze te kapacitetit dhe siperfaqes se vene ne dispozicion, eshte menduar se jetegjatesia e stacionit do te jete 15-20 vjet. Te stacioni kemi parashikuar edhe rrugen e aksesit, do kete nje peshore per matjen e mbetjeve. Duhet te percaktojme nje zone pilot, ndoshta ne qender ku ka me teper njerez, per te bere ndarjen e mbetjeve ne burim. Do kete dhe trajnime per te rinjte. Gjate rruges plani do kete edhe permiresime te metejshme. Leksi-eshte gje shume e mire ngritja e stacionit, vendi ekzistues ne Marinze cfare do behet, eshte gangrene e madhe per fshatin. Eksperti Z. Petrit-ai vend do te rehabilitohet per te eliminuar ndotjen ne ate pjese. Atje ka shume probleme dhe ndotje nga pusët e naftes, ndertesat e alpetrolit etj. Poshte pjeses se kodres mendoj te grumbullohen mbetjet nga njera ane dhe te ngjishen. Fondet per rehabilitimin e venddepozitimit mund te gjenden kollaj. Plani duhet plotesuar edhe me 4 anekse te tjera. Leksi-cfare investimi do kete per kete projekt, se duhen kosha specifik te ndare, duhet makine? Ka nje afat kohor ky projekt? Eksperti-afati kohor eshte 2 vjet. Ju keni mbeshtetjen e GIZ qe ka dhe nje fond te caktuar per te financuar. Problemi kryesor eshte ndergjegjesimi i komunitetit, qe te bejne ndarjen e mbetjeve ne shtepi. Problemin financiar e kemi ne rrugen e zgjidhjes. Eksperti sqaron ne menyre te detajuar studimin e fizibilitetit. Numri i kontiniereve llogaritet ne baze te numrit te popullsisë. Kemi ndare bizneset per Roskovecin dhe Njesite Administrative, kemi nxjere se sa ton mbetje nxjer ne vit Roskoveci dhe Njesite Administrative. Ne baze te kesaj llogaritje del dhe numri i kontiniereve se sa duhen. Do ti kerkojme GIZ nje mjet 8 tonesh. Leksi-na nxirni ne drite ne lidhje me plehrat, llogaritjet i beni vet ju. Problem-mbetjet inerte ne i llogarisim si mbetje urbane, por nuk eshte ashtu. Mbetjet inerte nuk duhet te hidhen prane pikave te grumbullimit. Gradualisht kete mbetje do te hiqen nga bashkia, jane menduar 2 skuadra. Fondi duhet te alokohet nga ata qe e perfitojne sherbimin. Elmazi-neve na sqaro thelbin me qarte. Eksperti-vendimi i kostove qe duhet alokuar nga konsumatori behet nga bashkia. Misioni i bashkise sigurimi cilesor i sherbimeve publike, te pastrimit, ndricimit, gjelberimit dhe mjedisit. Jemi ne fazen e llogaritjes se kostos, do nxjerim vlere reale sa kushton sherbimi. Eksperti sqaron dhe rekomandimet. Mateus-pyet per ndikimin ne mjedis? Eksperti sqaron se nuk do te kete ndotje. Kryetarja-cdo gje pershkruhet ne plan, sot kemi vetem nje vend ku hidhen plehrat, ne Marinze. Planifikimi yne eshte te ndertohet nje stacion ne Kuman, nuk ndikon kjo tek depoja e ujit se eshte me poshte. Siperfaqja 70% eshte shtet, per pjesen tjeter kemi filluar verifikimin. Ministria nuk na jep financim pa kete dokument qe ne po kalojme

sot.Ky plan duhet te kete te gjithë dokumentat qe kerkon ligji,ne menyre qe qeveria te japi ok per financimin e ketij projekti kaq emergjent per qytetin tone.Do te jete bashkefinancim realizimi i ketij projekti.Do te perpiqem te mar sa me shume financim nga qeveria,per pjesen tjeter do ju vij perseri materialet ne keshill,per pjesen e financimit nga bashkia.Me mbeshtetjen e GIZ do realizohet ndarja ne burim e mbejtjeve,llogaritja e sakte e kosos se sherbimit.Ky plan do kaloje per miratim ne keshillin e qarkut.Robert Murataj-kemi 1 vit qe punojme me planin e menazhimit te mbejtjeve urbane.Menaxhimi i mbejtjeve eshte nje problem shume i madh,duhen edhe sanksione per realizimin e objektivave.Mund te beni nje bashkepunim me bashkine Patos.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit te paraqitur dhe prezantimit te bere sot,dhe miratohet unanimsht me 17 vota pro plani i menaxhimit te integruar te mbejtjeve te ngurta urbane dhe studimi i fizibilitetit per stacionin e transferimit te mbejtjeve.

10.Per miratimi fondesh shtese ne buxhetin e bashkise Roskovec per vitin 2020.

Dr.Finances sqaron fondet shtese ne baze te kerkesave te paraqitura nga drejtorite perkatese.Sqaron ne menyre te detajuar fondet sipas projektit te paraqitur.Fondi ka ardhur nga qeveria.Aleksanderi pyet-do zbatohet per te gjitha shkollat?Pergjigja eshte po,per shkollat e gjithë territorit te bashkise marrja e masave ndaj covid-19.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimsht me 17 vota pro,

11.Per ndryshimin e pergjegjesise se administrimit te pronave nga shoqeria aksionere “alpetrol” ne pronesi te Bashkise Roskovec.

Dr.Urbanistikes sqaron projektin per ndryshimin e pergjegjesise se administrimit te pronave nga shoqeria aksionere Alpetrol ne pronesi te bashkise Roskovec.Kryetarja-na ka ardhur nje kerkese nga ASHK-ja e cila kerkon nje ser dokumentash per te finalizuar kete procedure.Kur te bejme shpronesimin e ish-SMT,ata dy persona qe ushtrojne aktivitet mund ta vazhdojne ne keto prona.Ne do vazhdojme procedurat me ASHK per ta finalizuar si procedure.Bujari-mund te kete kontradita midis Alpetrolit dhe bashkise?Kryetarja-do kemi marrveshje me Alpetrolin,por duhet edhe vendimi i keshillit.Sot per sot ne kemi shpjegim vetem per 6 prona se per cfare i duam.Kryetarja-keto nuk jane prona tona,jane te Alpetrolit.Leksi-kjo eshte gje e mire sic e thame dhe ne mbledhjen e pare,por duke mar keto prona mos ngelen ata persona qe punojne ne ruajtje pa pune?Kryetarja-nuk ka lidhje me kete.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimsht me 17 vota pro(3/5+4) vota pro,sipas materjalit te paraqitur.

12.Per miratimin e Formularit Tip per paraqitjen e kerkesave,per cdo program social strehimi.

P/Sherbimeve Arben Dukaj sqaron projektin e formularit tip per paraqitjen e kerkesave per cdo program social strehimi.Procedura ligjore kerkon qe cdo qytetar duhet te paraqesi kerkesen ne baze te atij formulari tip.Kemi patur takim me Entin e Banesave per finalizimin e marrveshjes.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimsht me 17 vota pro.

13.Informacion mbi ndertimin e Memorialit,Roskovec.

Dr.juridike sqaron ne menyre te permbledhur te gjitha hapat e ndermarra per ndertimin e Memorialit.Autori i projektit sqaron se ndertimi i Memorialit nuk e cenon projektin.Financimi do jete nga familja Begaj dhe nje pjese nga bashkia.Perfundimisht kesaj ceshtje i eshte dhene zgjidhje ligjore,nuk ka dal akoma leja e ndertimit.Sa te dal leja do filloje puna per ta perfunduar kete veper arti.Eshte realizuar procedura e prokurimit publik dhe eshte lidhur kontrata me firmen fituese.Pas marrjes se lejes se ndertimit do filloje puna.

14.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Elmazi-thekson problemin e nenes se z.G.Hoxha e cila eshte ne cader.Nga ana ligjore bashkia nuk ka detyrime se e ka ndihmuar 1 here,por nga ana morale mendoj te shikohet dhe ndihmohet.Kryetarja-nga ana ligjore une e kam ndihmuar,por ajo nuk eshte e vetme ka familjare.Por raste si ajo ka pafund,ligjerisht ne e kemi ndihmuar dhe permbushur detyrimin.Leksi-ai fond qe erdhi nuk u menaxhua ne rregull,apo e kane rrezuar vet shtepine nga themelet?Qytetari eshte shprehur- ma filloni nga themelet se pjesen tjeter e bej vet.Elmazi-ne kemi detyrimin per ti ndihmuar qytetaret,a ka mundesi ne si keshill te kalojme nje fond per ta ndihmuar kete familje?Kryetarja-raste si kjo jane pafund,por ky nuk eshte nje rast me emergjent se te tjeret,nuk eshte rast ekstrem.Ajo nene ka femije nuk eshte e vetme.Leksi-kerkon per kete problem informacion me shkrim,dhe per pjesen e dyte te investimeve listen e perfituesve.Vjollca-ne Ngjeqar bente mase linja e ndricuesve me linjat e korentit.Vera-ankese per postierin ne lidhje me marrjen e shperblimit te lindjes.Kryetarja-bej ankese me shkrim.Leksi-rrugen me cakull te Jagodines,investimi qe eshte bere nga ujesjellsi tek lagja Themi Goga eshte prishur rera bituminoze komplet.Ne lidhje dhe me pastrimin e perroit,hedhja e dherave dhe mbeturinave,edhe per cilesine e trotuareve.Kryetarja-ujesjellsi duhet ta kthej rrugen sic ishte.Leksi-pyet edhe per rrugen e Marinzes nga bukuroshja dhe ne vazhdim.Aleksander-kerkese per orarin e mbledhjeve,te lihet pas ores 2 se ne e kemi te pamundur te levizim nga puna.Bujari-si do vej problem i rruges nga Shushenjt per te vene tapetin,firma ndertuese nuk kane lene asnje mundesi per te kaluar fermeret ne toka.Kryetarja i le porosi Rakipit dhe Benit per verifikime sesa tombino duhen per kalimin e fermereve ne tokat e tyre.Elmazi-keta jane 4 apo 5 mesues,te biem dakort apo jo me orarin qe propozoi Aleksandri.Keshilltaret nuk bien dakort ne nje mendim per orarin.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

